

## Procesverbal- Tipi i kontratës - Mallra

### **PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

**Objekti i procedurës:** “Blerje automjeti me kosh”.

**Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (FPP):** 34144000-8

**Vlera e fondit limit:** 8,330,000 (tetëmilion e treqindetridhjetëmijë) lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, autoriteti kontraktor, Ndërmarrja e Shërbimeve Publike Himarë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

#### **2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT**

##### **1. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 82 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 83 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) dhe nenin 30 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar).

##### **2. Ofertuesi duhet të paraqesë:**

##### **2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

*2.1.1. Operatori ekonomik duhet të disponojë licensë me kod VII.3.B1 të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit “Blerja, shitja e mjeteve me motor dhe rimorkio”.*

**Argumentimi:** Ky kriter është vendosur bazuar në nenin 77, pika 1/a të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale” dhe nenin 40, pika 4/ a), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” (i ndryshuar) ku parashikohet se: “Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) licencat profesionale për prodhimin dhe ose furnizimin e mallrave, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore”

Ky kriter është i domosdoshëm pasi lidhet drejtpërdrejt me përshtatshmërinë profesionale të operatorit ekonomik për të ushtruar aktivitetin që përbën objektin e kontratës. Kërkesa për një licensë të posaçme që autorizon ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të mjeteve me motor dhe

rimorkiove shërben si provë e drejtpërdrejtë se operatori ekonomik është i regjistruar dhe i autorizuar sipas legjislacionit në fuqi për të zhvilluar këtë veprimtari.

Ushtrimi i aktivitetit të tregimit të mjeteve me motor në Shqipëri i nënshtrohet regjimit të licencimit sipas kuadrit rregullator për licencat dhe lejet, të administruara nga institucionet shtetërore përkatëse, si Qendra Kombëtare e Biznesit, në zbatim të legjislacionit për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë. Kjo do të thotë se çdo subjekt që kryen aktivitetin e blerjes dhe shitjes së mjeteve me motor duhet të jetë i pajisur me licencën përkatëse të kategorisë VII.3.B1. Për rrjedhojë, ky kriter siguron që operatori ekonomik që do të kontraktohet nga autoriteti publik të jetë në përputhje me kërkesat ligjore për ushtrimin e këtij aktiviteti dhe të mos ushtrojë veprimtari në mënyrë të paligjshme. Nga pikëpamja teknike dhe funksionale, kjo licencë përfaqëson një garanci minimale se operatori ekonomik zotëron strukturën organizative, regjistrimin e duhur të aktivitetit dhe kapacitetin profesional për të realizuar procesin e furnizimit, tregimit dhe transferimit të pronësisë së mjeteve me motor sipas rregullave dhe standardeve të përcaktuara nga legjislacioni në fuqi. Në procedurat e prokurimit ku objekti i kontratës lidhet me furnizimin me automjete, autoriteti kontraktor duhet të sigurojë që furnizuesi të jetë subjekt i specializuar në këtë fushë dhe të operojë në mënyrë të ligjshme në tregun e automjeteve. Ky kriter garanton që pjesëmarrësit në procedurë të kenë autorizimin ligjor dhe kapacitetin profesional për të realizuar kontratën në mënyrë të rregullt, duke mbrojtur interesin publik dhe duke siguruar që autoriteti kontraktor të furnizohet me mjete nga operatorë ekonomikë të licencuar dhe të përgjegjshëm për aktivitetin që ushtrojnë.

## **2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:**

*2.2.1 OE duhet të paraqesë vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023 dhe 2024, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit.*

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar; nenin 43 pika 2/c dhe nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr. 29/2023 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: *“Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”*. Vendosija e këtij kriteri bëhet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të operatorëve ekonomikë ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën siç është parashikuar nga Autoriteti Kontraktor.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 39 % e vlerës së fondit limit është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se: *“Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: c) 40 % të vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar...”*. Në nenin 55 pika 4 të VKM Nr 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar është përcaktuar se: *“Kërkesat ekonomike financiare duhet të kërkohen në raport me objektin e prokurimit, duke marrë në konsideratë që plotësimi i këtyre*

*kërkesave mund të bëhet vetëm me paraqitjen e xhiros vjetore të realizuar nga operatorët ekonomikë. Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure prokurimi nuk mund të tejkalojë 40% të vlerës së përllogaritur të kontratës, sipas parashikimeve në nenin 43, të këtyre rregullave”.*

Referuar sa më sipër duke qënë se vlera e fondit limit është në kufirin e vlerës që i përket llojit të procedurës “Procedurë e hapur të thjeshtuar” edhe vlera e kërkuar për xhiron do të vendoset konform kësaj procedure prokurimi referuar dispozitave ligjore si më sipërcituar.

## **2.3 Kapaciteti teknik:**

*2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në vlerën jo më pak se 19 % e vlerës së fondit limit. Këto furnizime të mëparshme, të ngjashme, duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:*

*a. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetimin e lëshuar nga enti publik për përmbushjen me sukses të kontratës dhe/ose faturat tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

*b. Kur furnizimet e ngjashme janë realizuar me subjekte private, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.*

### **Argumentimi:**

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën” nenit 55, pika 4(b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar ku përcaktohet se “Për kontratat e mallrave dhe shërbimeve vlera totale e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të madhe se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 19 % të vlerës së fondit limit. Kjo vlerë është vendosur duke marrë parasysh përcaktimet e bëra në nenin 55, pika 4, gërma (b) e VKM nr. 285 dt 19.05.2021 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, duke qënë se vlera e fondit limit është nën kufirin e ulët monetar që zhvillohet procedura e hapur e thjeshtuar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimit për realizimin me sukses të kontratës.

*2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë që disponon servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin e mjetit objekt i prokurimit, gjatë periudhës së*

*garancisë, në servisin e tij/një servisi të marrë me qera, apo përmes një servisi me të cilin mund të ketë të lidhur një kontratë bashkëpunimi të vlefshme përgjatë kohës së realizimit të kontratës, dhe te specifikojë adresën e servisit.*

**Argumentimi:** Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe pikën 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë se disponon një servis të specializuar dhe garanton kryerjen e shërbimeve për riparimin dhe mirëmbajtjen e mjetit objekt prokurimi gjatë periudhës së garancisë përbën një kriter të domosdoshëm kualifikimi si nga pikëpamja teknike ashtu edhe nga ajo ligjore, pasi lidhet drejtpërdrejt me aftësinë e operatorit ekonomik për të garantuar funksionimin normal dhe të vazhdueshëm të mjeteve që do të furnizohen. Duke qenë se objekt i kontratës është furnizimi me mjete me motor, është thelbësore që operatori ekonomik jo vetëm të realizojë furnizimin e tyre, por edhe të sigurojë mbështetje teknike dhe shërbim pas shitjes gjatë periudhës së garancisë, në mënyrë që autoriteti kontraktor të ketë mundësi të kryejë riparime dhe ndërhyrje teknike në kohë dhe sipas standardeve. Ekzistenca e një servisi të specializuar, qoftë në pronësi, me qira apo përmes një kontrate bashkëpunimi, garanton që operatori ekonomik disponon kapacitetin teknik dhe infrastrukturën e nevojshme për të përmbushur detyrimet që rrjedhin nga kontrata, duke siguruar ndërhyrje profesionale, përdorimin e pajisjeve të përshtatshme dhe personel teknik të kualifikuar për diagnostikimin dhe riparimin e mjeteve. Në të njëjtën kohë, kërkesa për specifikimin e adresës së servisit i mundëson autoritetit kontraktor të verifikojë ekzistencën reale të këtij kapaciteti teknik dhe të sigurohet që shërbimi i mirëmbajtjes dhe riparimit të jetë i aksesueshëm dhe i realizueshëm në praktikë gjatë gjithë periudhës së garancisë.

*2.3.3 Operatori ekonomik duhet të deklarojë që mjeti është prodhuar në vendet e Bashkimit European ose të jenë të prodhuara për përdorim në vendet e BE.*

**Argumentim:** Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të

*shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe pikë 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Ky kriter lidhet drejtpërdrejt me garantimin e standardeve të cilësisë, sigurisë dhe përputhshmërisë teknike të mjeteve që do të furnizohen në kuadër të kontratës publike. Mjetet e prodhuara në vendet e Bashkimit Europian ose të projektuara për tregun e BE-së janë të detyruara të përmbushin një sërë standardesh dhe rregullash teknike që lidhen me sigurinë rugore, mbrojtjen e mjedisit, emetimet e gazeve, sistemet e sigurisë aktive dhe pasive, si dhe me cilësinë e prodhimit dhe kontrollin teknik të mjeteve. Për këtë arsye, kërkesa që mjeti të jetë prodhuar për tregun e BE-së siguron që automjetet të jenë në përputhje me standardet teknike europiane dhe të mund të përdoren dhe regjistrohen pa pengesa në Republikën e Shqipërisë, duke qenë se legjislacioni shqiptar në fushën e transportit rrugor dhe homologimit të mjeteve është në një masë të madhe i harmonizuar me standardet dhe direktivat e Bashkimit Europian. Ky kriter garanton që mjeti të jetë i ndërtuar sipas specifikimeve të tregut europian, të ketë kaluar procedurat e homologimit dhe të përmbushë kërkesat për sigurinë e përdoruesve dhe për mbrojtjen e mjedisit, si dhe të jetë i pajisur me komponentë dhe sisteme që janë të certifikuara dhe të njohura në tregun europian. Njëkohësisht, siguron që për mjetin të ekzistojë rrjet i konsoliduar shërbimesh, pjesësh këmbimi dhe mbështetje teknike në tregun europian dhe në Shqipëri, gjë që është e rëndësishme për mirëmbajtjen dhe funksionimin afatgjatë të automjetit gjatë përdorimit nga autoriteti kontraktor.

*2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë skedën teknike të mjetit ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat teknike të tij, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit, të përcaktuara në Shtojcën 6 të DST-së.*

**Argumentimi:** Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe pikë 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Ky kriter është i domosdoshëm pasi lidhet drejtpërdrejt me verifikimin e përputhshmërisë së ofertës me specifikimet teknike të përcaktuara nga autoriteti kontraktor. Nga pikëpamja teknike, skeda teknike e mjetit përfaqëson dokumentin kryesor referues që përmban të dhënat dhe parametrat e prodhuesit lidhur me karakteristikat funksionale dhe teknike të automjetit, si fuqia e motorit, kapaciteti cilindrik, dimensionet, sistemi i transmetimit, pajisjet e sigurisë, standardet e emetimeve dhe elementë të tjerë teknikë që lidhen me performancën dhe funksionalitetin e mjetit. Paraqitja e këtij dokumenti, së bashku me identifikimin dhe markimin e qartë të karakteristikave që korrespondojnë me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, i mundëson autoritetit kontraktor të kryejë një vlerësim objektiv dhe të verifikueshëm të ofertave, duke krahasuar në mënyrë të drejtpërdrejtë parametrat teknikë të mjetit të ofertuar me specifikimet teknike të kërkuara. Në këtë mënyrë sigurohet që mjeti i propozuar nga operatori ekonomik i përmbush realisht kërkesat funksionale, teknike dhe të performancës të parashikuara në dokumentet e procedurës.

*2.3.5 Deklaratë garancie për mjetet e ofruara, ku të jetë përcaktuar periudha e garancisë jo më pak se 1 (një) vit ose 20,000 (njëzetmijë) km.*

**Argumentimi:** Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe pikë 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë garancie për mjetet e ofruara, ku të përcaktohet një periudhë garancie jo më pak se 1 vit ose 20,000 km, përbën një element të rëndësishëm teknik që synon të garantojë cilësinë, besueshmërinë dhe funksionimin e qëndrueshëm të mjeteve që do të furnizohen. Duke qenë se automjetet janë produkte teknike që i nënshtrohen përdorimit të vazhdueshëm dhe konsumimit të komponentëve gjatë funksionimit, ekzistenca e një periudhe garancie të përcaktuar siguron që çdo defekt i mundshëm që lidhet me prodhimin, materialet apo montimin e mjetit të trajtohet dhe të riparohet nga furnizuesi pa kosto shtesë për autoritetin kontraktor. Kjo kërkesë krijon një garanci minimale për performancën dhe qëndrueshmërinë e mjetit gjatë një periudhe fillestare përdorimi, e cila zakonisht është edhe faza ku mund të evidentohen defekte të mundshme të prodhimit. Në këtë mënyrë, deklarata e garancisë shërben si një instrument teknik që siguron mbrojtjen e interesave të autoritetit kontraktor dhe garanton që mjetet e furnizuara të jenë funksionale, të qëndrueshme dhe të mbështetura me shërbim teknik gjatë periudhës fillestare të përdorimit. Ajo krijon gjithashtu një nivel të qartë përgjegjësie

për operatorin ekonomik lidhur me cilësinë e produktit të ofertuar dhe përmbushjen e detyrimeve që lidhen me funksionimin normal të automjetit pas dorëzimit.

*2.3.6 Deklaratë ku merr përsipër dorëzimin e mjetit të targuar dhe regjistruar në pronësi të autoritetit kontraktor përfitues, ku të ketë të përfshira në çmim të gjithë dokumentacionin përkatës për qarkullim në përputhje me legjislacionin përkatës të Republikës së Shqipërisë.*

**Argumentimi:** Ky kriter bazohet në pikën 4, të nenit të 77, të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, ku parashikohet se “4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvojë që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën. Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe pikë 8 të nenit 40, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, ku parashikohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t’u garantuar se mjeti do të dorëzohet pranë AK i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor në emër të AK-së. Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër dorëzimin e mjetit të targuar dhe të regjistruar në pronësi të autoritetit kontraktor përfitues, duke përfshirë në çmim të gjithë dokumentacionin e nevojshëm për qarkullim, përbën një element të rëndësishëm teknik që lidhet me garantimin e funksionalitetit të plotë të mjetit në momentin e dorëzimit. Duke qenë se automjetet janë mjete që për të qarkulluar ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë duhet të jenë të regjistruara dhe të pajisura me dokumentacionin përkatës, kjo kërkesë siguron që mjeti i furnizuar të jetë i gatshëm për përdorim të menjëhershëm nga autoriteti kontraktor pa pasur nevojë për procedura shtesë administrative apo teknike pas dorëzimit të tij. Nga pikëpamja teknike dhe funksionale, dorëzimi i mjetit të targuar dhe të regjistruar nënkupton që automjeti ka kaluar të gjitha procedurat e nevojshme të identifikimit dhe regjistrimit, duke përfshirë dokumentacionin teknik të mjetit, certifikatat përkatëse, si dhe çdo dokument tjetër të kërkuar për qarkullim. Përfshirja e këtyre elementeve në çmimin e ofertës siguron që autoriteti kontraktor të ketë një pasqyrë të qartë dhe të plotë të kostos reale të furnizimit, duke shmangur shpenzime të paparashikuara apo kosto shtesë që mund të lindnin gjatë procesit të regjistrimit dhe targimit të mjetit. Kjo gjithashtu kontribuon në një planifikim më të saktë të fondeve dhe në një vlerësim më transparent të ofertave të paraqitura nga operatorët ekonomikë. Njëkohësisht, kjo kërkesë garanton që operatori ekonomik të marrë përgjegjësinë për përmbushjen e të gjitha procedurave teknike dhe administrative që lidhen me përgatitjen e mjetit për qarkullim, duke siguruar që automjeti të dorëzohet në gjendje plotësisht funksionale dhe të pajisur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm. Në këtë mënyrë sigurohet që mjeti të jetë i gatshëm për përdorim operativ nga autoriteti

kontraktor menjëherë pas dorëzimit, duke shmangur vonesa në vënien në shfrytëzim të tij dhe duke garantuar një realizim më efikas të objektit të kontratës.

Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Specifikimet teknike:

**Të dhëna të përgjithshme të mjetit:**

- Viti i prodhimit: jo më parë se 2018
- Kilometra të përshkuara: max. 60,000 km
- Orë pune të platformës: jo më shumë se 1,000 orë
- Karburanti: naftë
- Standardi mjedisor: euro 6 + sistem AdBlue
- Kambio: automatike
- Cilindrata: 2800 ÷ 3000 cc
- Fuqia motorike: 130 ÷ 140 kW
- Numri i cilindrave: 4
- Sistemi i drejtimit: hidraulik
- Numri i akseve: 2
- Konfigurimi: 4x2
- Goma përpara: 195/75/R16 (2 copë, teke)
- Goma e pasme: 195/75/R16 (4 copë, dopio)
- Distanca aksiale: 3500 ÷ 3600 mm
- Pesha totale me ngarkesë: 5,000 ÷ 5,500 kg
- Dy dyer kabine
- Minimumi 2 persona në kabinë
- Kamera për pamje të pasme
- Sistem A/C

Platforma ajrore hidraulike:

- Lartësia e punës: minimumi 17 metra nga toka
- Kapacitet për dy persona njëkohësisht
- Pajisje me dalje energjie 220V në kosh
- Komandim i sigurt dhe sistem stabilizues

Karroceria:

- Tip furgon i mbyllur
- Derë anësore me shina
- Derë e pasme tip grilë
- Mbrojtje e plotë e paneleve të komandimit dhe sistemit hidraulik nga agjentët atmosferikë

Pajisje shtesë të detyrueshme:

- Tahograf Digjital
- Radio CD
- Dritare me komandim elektrik
- Pasqyra me komandim elektrik

Sasia e mallit që kërkohet: automjet me kosh 1 (një) copë

Specifikimet teknike janë hartuar nga sektori i transportit dhe logjistikës dhe përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që e vlerëson mallin si të pranueshëm për funksionet e kërkuara si dhe është në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Argumentimi teknik dhe ligjor i specifikimeve teknike për blerjen e një automjeti me platformë ajrore hidraulike (kosh) nga NSHP Himarë lidhet drejtpërdrejt me nevojën e institucionit për të kryer në mënyrë të sigurt dhe efikase shërbimet publike në territorin e Himarë. Ndërmarrja është përgjegjëse për mirëmbajtjen e ndriçimit publik, ndërhyrjet në shtyllat dhe rrjetet elektrike, mirëmbajtjen e elementëve të infrastrukturës urbane, punimet në lartësi në ndërtesa publike si dhe ndërhyrjet në gjelbërim apo elementë të tjerë që kërkojnë akses të sigurt në lartësi. Për kryerjen e këtyre shërbimeve është i domosdoshëm një automjet i specializuar i pajisur me platformë ajrore hidraulike, i cili garanton siguri për punonjësit, efikasitet në punë dhe ndërhyrje të shpejta në zona urbane dhe turistike.

Përcaktimi që automjeti të jetë i prodhuar jo më parë se viti 2018 synon të garantojë që mjeti të jetë relativisht i ri, të përmbushë standardet moderne të sigurisë dhe të ketë jetëgjatësi më të madhe në përdorim. Automjetet e prodhuara në vitet e fundit përfshijnë teknologji më të avancuar të motorit, sisteme më të sigurta frenimi dhe stabiliteti si dhe standarde më të larta për mbrojtjen e mjedisit, çka e bën investimin publik më të qëndrueshëm në kohë.

Kriteri që automjeti të ketë jo më shumë se 60,000 kilometra të përshkuara është vendosur për të garantuar që mjeti të jetë në gjendje shumë të mirë teknike dhe të mos ketë konsum të konsiderueshëm të komponentëve mekanikë. Automjetet me kilometrazh të ulët kanë rrezik më të ulët defektesh dhe kërkojnë më pak ndërhyrje mirëmbajtjeje, duke ulur kostot për institucionin. Në të njëjtën logjikë është përcaktuar edhe kufiri maksimal prej 1,000 orësh pune për platformën ajrore, pasi kjo është pjesa kryesore funksionale e mjetit dhe duhet të garantojë siguri të lartë gjatë operimit në lartësi. Kufizimi i orëve të punës siguron që sistemi hidraulik, krahët e platformës dhe mekanizmat e stabilizimit të mos jenë të konsumuar dhe të ofrojnë performancë të besueshme.

Përdorimi i motorit me karburant naftë konsiderohet zgjidhja më e përshtatshme për automjete pune, pasi ofron moment më të lartë rrotullues dhe konsum më të ulët karburanti në krahasim me motorët me benzinë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme për automjetet që transportojnë pajisje të rënda dhe që përdoren për shërbime intensive. Në të njëjtën kohë, kërkesa që motori të plotësojë standardin mjedisor Euro 6 dhe të jetë i pajisur me sistem AdBlue është vendosur për të garantuar përputhjen me standardet moderne të mbrojtjes së mjedisit dhe për të reduktuar emetimet e gazrave ndotës. Ky standard kontribuon në uljen e emetimeve të oksideve të azotit dhe grimcave ndotëse dhe është në përputhje me politikat mjedisore të institucioneve publike dhe praktikat europiane.

Specifikimi që automjeti të jetë me kambio automatike synon të rrisë komoditetin dhe sigurinë e drejtuesit gjatë përdorimit në trafikun urban. Automjetet e përdorura për shërbime publike kryejnë shpesh ndalesa dhe manovra të shumta dhe përdorimi i kambios automatike redukton lodhjen e

drejtuesit dhe rrit kontrollin e mjetit. Parametrat e cilindratës nga 2800 deri në 3000 cc dhe fuqisë motorike nga 130 deri në 140 kW janë përcaktuar për të siguruar performancën e nevojshme për transportimin e platformës ajrore dhe pajisjeve të tjera të punës, duke garantuar njëkohësisht stabilitet dhe fuqi të mjaftueshme gjatë përdorimit në terrene të ndryshme. Vendosja e intervaleve dhe jo e vlerave fikse mundëson pjesëmarrjen e disa prodhuesve në procedurën e prokurimit dhe shmang kufizimin e konkurrencës.

Konfigurimi i automjetit me dy akse dhe sistem drejtimi 4x2 është konsideruar i përshtatshëm për përdorim në rrugë urbane dhe në zona të banuara, pasi ofron manovrim më të lehtë, konsum më të ulët karburanti dhe kosto më të ulët mirëmbajtjeje krahasuar me konfigurimet me tërheqje të plotë. Distanca aksiale prej 3500 deri në 3600 mm është përcaktuar për të siguruar një raport optimal midis stabilitetit të automjetit gjatë përdorimit të platformës dhe manovrimit në rrugë të ngushta urbane. Në të njëjtën kohë, pesha totale me ngarkesë në intervalin 5000 deri në 5500 kg është e përshtatshme për mbajtjen e platformës ajrore dhe pajisjeve të punës pa cenuar stabilitetin e automjetit gjatë operimit.

Platforma ajrore hidraulike duhet të sigurojë një lartësi pune jo më pak se 17 metra nga toka, pasi kjo lartësi është e nevojshme për ndërhyrje në shtyllat e ndriçimit publik, në elementë të infrastrukturës elektrike dhe në ndërtesa disa katëshe. Kapaciteti për të mbajtur dy persona njëkohësisht në kosh është një element i rëndësishëm sigurie dhe efikasiteti, pasi në shumë raste punimet kërkojnë praninë e operatorit dhe një tekniku tjetër. Pajisja e koshit me dalje energjie 220 volt mundëson përdorimin e veglave elektrike gjatë ndërhyrjeve, ndërsa sistemi stabilizues është një komponent thelbësor sigurie që parandalon lëkundjen ose përmbysjen e mjetit gjatë punës në lartësi.

Karroceria e tipit furgon i mbyllur është zgjedhur për të mundësuar transportin dhe ruajtjen e veglave të punës, materialeve elektrike dhe pajisjeve të mirëmbajtjes në kushte të sigurta. Prania e derës anësore me shina dhe e derës së pasme tip grilë lehtëson ngarkimin dhe shkarkimin e pajisjeve gjatë punës në terren. Gjithashtu është kërkuar mbrojtje e plotë e paneleve të komandimit dhe e sistemit hidraulik nga agentët atmosferikë, pasi kushtet klimatike dhe ekspozimi ndaj lagështirës dhe kripës detare në zonën bregdetare të Himarë mund të ndikojnë negativisht në jetëgjatësinë e pajisjeve nëse ato nuk janë të mbrojtura.

Pajisjet shtesë si tahografi digjital, kamera për pamje të pasme, sistemi i ajrit të kondicionuar, radio, dritaret dhe pasqyrat me komandim elektrik janë elementë standardë për automjetet moderne dhe kontribuojnë në rritjen e sigurisë, komoditetit dhe kontrollit gjatë përdorimit të mjetit. Tahografi digjital mundëson monitorimin e përdorimit të automjetit dhe administrimin më të mirë të flotës së institucionit, ndërsa kamera e pasme rrit sigurinë gjatë manovrimit në hapësira të kufizuara urbane.

Në përfundim, specifikimet teknike të përcaktuara për këtë automjet janë të lidhura drejtpërdrejt me funksionin që do të kryejë mjeti dhe me nevojat reale operative të NSHP Himarë. Ato janë hartuar në mënyrë të tillë që të garantojnë performancë, siguri dhe jetëgjatësi të investimit publik, duke respektuar njëkohësisht kërkesat e Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” dhe parimet e konkurrencës së hapur në procedurat e prokurimit publik. Specifikimet nuk favorizojnë një markë apo model të caktuar automjeti, por përcaktojnë parametra teknike funksionale që mund të përmbushen nga disa prodhues dhe operatorë ekonomikë në treg.

## **NJËSIA E PROKURIMIT**